



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Raportimi Financiar për vitin 2022

A .PËRMBLEDHJE

Nëpërmjet këtij raporti paraqitet në mënyrë të përmbledhur aktiviteti financiar për periudhën janar– dhjetor 2022.

Raporti synon të jap realizimin e objektivave kryesore të punësimit dhe realizimin e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor të vitit 2022.

B.MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar bëhet bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

- Fonde te ardhura nga Ministria e Drejtësisë, sipas e-mailit zyrtar datë 22.12.2021 ishte si më poshtë:

- Paga	14,400,000 lekë
- Sigurime shoq. dhe shend.	2,700,000 lekë
- Shpenzime operative	6,000,000 lekë
- Investime	1,000,000 lekë

Më pas është bërë shtesa e fondit special 100,000 lekë, llogaria ekonomike 606, sipas shkresës nr. 420/3, prot, datë 17.02.2022. Me shkresë nr. 781/3 prot, datë 25.03.2022 kanë ardhur fonde për shpenzime kapitale në llogarinë 231, përkatësisht 610,000 lekë TVSH, kodi M140312, Blerje pajisje elektronike për QPKMR, dhe 390,000 lekë, kodi M140058, Blerje pajisje zyre për QPKMR. Në datë 07.09.2022 më shkresën nr. 4772 prot është pakësuar llogaria ekonomike 602 në vlerën 2,000,000 lekë. Me datë 17.10.2022 me nr prot 5304/2 janë miratuar fonde për shpenzime korente në vlerën 1,500,000 lekë dhe pakësim në sumën 180,000 të cilat janë kaluar në llogarinë ekonomike 606.

Përmbledhese e fondeve të alokuara në tabelën më poshtë sipas rishikimeve të buxhetit :

Nr	Emertimi	Shuma
1.	Fondi i pagave	12,000,000
2.	Fondi për sig shoqërore dhe shëndetësore	2,200,000
3.	Fondi për shpenzime operative me kod 91401AD	5,320,000
4.	Fondi special 606	280,000
5.	Investime	1,000,000
	Totali	20,800,000

Realizimi i fondeve për vitin janar –dhjetor 2022.

Nr	Emertimi	Plani vjetor	Fakti vjetor	% e realizimit
1.	Shpenzime për paga	12,000,000	11,929,937	99
2.	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,200,000	1,992,325	91
3.	Shpenzime operative	5,320,000	4,263,486	80
4.	Fond special	280,000	181,500	65
5.	Investime	1,000,000	904,680	90
	Totali	20,800,000	19,271,928	93

1. PERFORMANCA ANALITIKE E BUXHETIT

SHPENZIME PËR PAGA DHE SIGURIME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Buxheti i alokuar për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore është 14,200,000, i cili është realizuar në masën 98%. Fondi i pagave është realizuar në masën e planifikuar pasi struktura është plotësuar dhe nuk ka vende vakante.

SHPENZIMET OPERATIVE

Për shpenzimet operative fondi i alokuar është 5,320,000 lekë. Sipas regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike 2022, jepet realizimi zë më zë i shpenzimeve (llog 602) në tabelën më poshtë:

Nr	Emertimi I shpenzimeve	Buxheti	Realizimi	%
1	Kancelari	120,000	118,129	98
2	Materiale Pastrimi dhe dizinfektimi	48,000	47,160	98
3	Materiale zyre tonera dhe bojra printer	100,000	100,000	100
4	Furnizime me materiale te tjera zyre	120,000	118,992	99
5	Libra dhe Publikime profesionale	280,000	141,000	50
6	Shpenzime per fletpalosje, kartvizita etj	120,000	107,619	89
7	Shërbime dizenjimi	120,000	120,000	100
8	Shërbime postare	36,000	11,050	31
9	Shërbime pastrimi	80,000	80,000	100
10	Shpenzime printime dhe publikime	120,000	109,216	91
11	Shërbime te tjera	120,000	120,000	100
12	Karburant dhe lubrifikant	250,000	179,760	72
13	Pjesë këmbimi goma dhe bateri	120,000	119,280	99
14	Shpenzime per siguracionin e mjeteve te transportit	30,000		
15	Shpenzime te tjera transporti	120,000	118,920	99
16	Udhëtim e dieta brenda vendit	484,000	224,820	46
17	Udhëtim e dieta jashtë vendit	150,000	84,234	56
18	Bileta avioni	100,000	81,000	81
19	Shërbime për mirëmbajtje te objekteve ndertimore	120,000	120,000	100
20	Shpenzime Mirembajtje pajisje zyre(faqe ëeb)	120,000	119,400	99
21	Qeramarrje ambjentesh per aktivite	440,000	194,439	44

22	Qeramarrje mjeteve transporti	100,000	60,000	60
23	Qeramarrje pajisje autovizuale per aktivite	200,000	99,976	50
24	Shpenzime perkthimi	92,000	78,000	85
25	Shpenzime per tatim taksa	40,000	30,491	76
26	Shpenzime të tjera material dhe sherbime operative paparashikuara (Spot, etj)	1,870,000	1,680,000	89
	Totali me kod 91401AD	5,500,000	4,263,487	80
	Kalim nga llogaria 602 i shumës 180,000 në llogarinë ekonomike 606 në zbatim të An nr.19/2022 dhe VKM nr.898, date 29.12.2022 pra, 5,500,000-180,000=5,320,000	5,320,000	4,263,487	80

Realizimi i shpenzimeve operative (602) është në masën 80%, pasi aktiviteti i Qendrës ka patur në fokus promovimin dhe forcimin e marrëdhënieve institucionale si dhe zhvillimin e performancës. Gjatë kësaj periudhe është bërë i mundur realizimi i 3 spoteve në vlerën totale 1.680.000 lekë, materialet promocionale në vlerën 357.835 leke si dhe shpenzime të tjera operative në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese, si dhe në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit apo lirimit me kusht, me vlerën 2.225.651 lekë.

Fusha e veprimtarisë së Qendrës ka qenë e kufizuar deri në miratimin e **Vendimit nr. 655, datë 10.10.2022** për disa shtesa në vendimin nr. 149, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e të aksesimit, të dhënave parësore e dytësore dhe dhënësive të informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur” dhe **Vendimit nr. 656, datë 10.10.2022** për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 314, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e qendrës së parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve” në lidhje me funksionimin dhe organizimin e qendrës në arritjen e objektivave të planifikuara për realizim brenda vitit 2022.

INVESTIMET

Fondet për shpenzime kapitale në llogarinë ekonomike 231 për Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve janë me shkresë nr. 781/3 prot, datë 25.03.2022 përkatësisht:

- 610,000 lekë, kodi M140312, Blerje pajisje elektronike
- 390,000 lekë, kodi M140058, Blerje pajisje zyre

Nr	Emertimi i investimeve	Buxheti	Realizimi	%
01	Blerje pajisje elektronike për QPKMR	610,000	508,333	83
02	Blerje pajisje zyre për QPKMR.	390,000	325,000	83